

VENDIM
Nr. 558, datë 18.6.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA
VERIORE, KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza veriore, Korçë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “truall”, me sipërfaqe të përgjithshme 1 111 (një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) m² dhe vlerë të përgjithshme shpronësimi 10 200 880 (dhjetë milionë e dyqind mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 200 880 (dhjetë milionë e dyqind mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT "UNAZA VERIORE KORÇË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë						VLERA TOTALE (Lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Truall			Arë		Vlera në lekë		
						Sip. m ²	Cmimi m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Cmimi m ²			
1	Adriatik	Eqerem	Hasanllari	8563	4/189	44	9280	408,320				408,320	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Ardi	Fejzo	Fezga	8563	3/607	19	9280	176,320				176,320	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Gezim	Hysen	Shahinllari	8563	3/113	45	9280	417,600				417,600	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Vangjel	Kristo	Zharkolli	8563	2/89	56	9280	519,680				519,680	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Rita	Aleks	Zhidro	8563	2/201	17	9280	157,760				157,760	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Rita	Aleks	Zhidro	8563	2/200	27	9280	250,560				250,560	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Nevrus	Xhenali	Rusi	8563	2/95	18	9280	167,040				167,040	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Pasho	Demirali	Dyrmishllari	8563	2/96	22	9280	204,160				204,160	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Shkelqim	Hysni	Asabella	8563	2/356	25	9280	232,000				232,000	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Jani	Hysni	Asabella	8563	2/260	35	9280	324,800				324,800	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Kristaq	Foto	Gusho	8563	2/98	55	9280	510,400				510,400	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Pandi	Arqile	Tarusha	8563	2/210	130	9280	1,206,400				1,206,400	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Fiqiri	Sami	Venxha+Bp.	8563	2/376	92	9280	853,760				853,760	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Vangjel	Lefter	Evangeljliu	8563	2/136	115	9280	1,067,200				1,067,200	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Vangjel	Lefter	Evangeljliu	8563	2/404	110	9280	1,020,800				1,020,800	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Shkelqim	Esat	Venxha+Bp.	8563	2/222	174	9280	1,614,720				1,614,720	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Dhimiter	Jorgji	Çipi	8563	2/221	15	9280	139,200				139,200	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Shkelqim	Zenel	Xhialli	8562	6/447	112	8305	930,160				930,160	Çertifikatë pronësie
	TOTALI					1111.0		10,200,880				10,200,880	

